

KËRKESË
Nr. 7616, datë 16.12.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Korçë-Qafë-Ploçë” (shtesa).

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të

paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “arë” dhe “truall”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 1 474 764.7 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë shtatë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

RREPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR
“KORÇË – QAFË-PLOÇË” (SHTESAT)

Nr.	PRONARI	ZK	NR. PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE	VLERËSIMET			Kultura bujqësore	VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emri i pronarit					SIP (m ²)	ÇMIMI (LEK/m ²)	Vlera(lekë)			
1	Bashkëpronarët Hyko	3047	11\1	Arë	3000	2500	200	500000		500000	Konf. ZVRPP
2	Lytfi Dilaçer Ibi	1387	325/45	Arë	1500	300	200	60000		60000	Konf. ZVRPP
3	Rami Nazmi Mulla Esat Nazmi Mulla Myscret Nazmi Tollozhina	3047	11\3	Arë	2000	1847	200	369400		369400	Konf. ZVRPP
4	Edmond Hasimllari	3553	52/27	Truall	1250	97	1490	144530		144530	Pritet konfirmimi
5	Urim Mukollari	3553	47/31	Arë	1789	75	210	15750		15750	Pritet konfirmimi
6	Andrea Baki Bakollari Miranda Islam Bakollari	3496	1600/21	Arë		170			79650	79650	Konf. ZVRPP
7	Baki Halil Bakollari	3496	166/20	Arë		256			111950	111950	Konf. ZVRPP
8	Ilia Kristaq Shembitraku	1310	121/88	Truall	1500	63	2016.9	127064.7		127064.7	Certifikatë pronësie
9	I Pidentifikuar	3553	47/30	Arë		62	210	13020		13020	Pritet konfirmimi
10	Avdulla Bektash Leka	2420	110/59	Arë	1610	267	200	53400		53400	Pritet konfirmimi
TOTALI						5637		1283164.7	191600	1474764.7	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2014-3958 (1272), datë 6.11.2014, vendosi

shpalljen të vdekur të shtetasit Nazmi Gazidedja, i datëlindjes 6.8.1946, lindur në Brezhan, Dibër, dhe caktimin si datë vdekjeje 7.7.1991.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1787, datë 11.11.2014, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Astrit Banushaj, në datën 1.1.1976.

